



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 24.20.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË ADMINISTRATËS
TATIMORE TË KOSOVËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Administratës Tatimore të Kosovës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Blerim Kabashi (udhëheqës i ekipit), Ariana Berisha Rexhëbeqaj dhe Leonora Hasani (anëtare të ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Samir Zymeri.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	22
5 Qeverisja e mirë.....	23
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	26
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme	29
Shtojca III: Letër konfirmimi	33

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Administratës Tatimore të Kosovës për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, për vitin 2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK).

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin dhe stafin e ATK-së, për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017**

Drejtori i Përgjithshëm është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK). Ne kemi analizuar veprimtarinë e ATK-së se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

1. Opinion i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e ATK-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, nr.01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrollin e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të

mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri i Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të ATK-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga ATK kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK); dhe
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë.

Deklarata e bërë nga menaxhmenti i ATK-së

Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në MF, është e saktë dhe e drejtë. Gjatë auditimit nuk janë identifikuar gabime materiale.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit është menaxhimi i buxhetit, të hyrat, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare në përgjithësi kontrollet janë të mira, mirëpo disa mangësi janë vërejtur në orientimin e gabuar të projekteve në buxhet, procedimi i lëndëve për pagës, fusha e të hyrave, fusha e personelit dhe menaxhimi i pasurive. Këto fusha kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	9,889,944	8,951,857	8,807,446	8,858,097	8,079,103
Granti i Qeverisë -Buxheti	9,889,944	8,951,857	8,807,446	8,858,097	8,079,103

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 938,087€. Ky zvogëlim është pas rishikimit buxhetor dhe me vendime të Qeverisë.

Në vitin 2017, ATK ka shpenzuar 98% të buxhetit final ose 8,807,446€, nivel i njëjtë si në vitin 2016.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	9,889,944	8,951,857	8,807,446	8,858,097	8,079,103
Pagat dhe Mëditjet	7,012,775	6,881,449	6,881,449	6,889,254	6,585,102
Mallrat dhe Shërbimet	1,188,597	1,632,436	1,528,474	1,423,735	1,196,993
Shërbimet komunale	168,572	174,972	166,070	184,339	202,898
Investimet Kapitale	1,520,000	263,000	231,453	360,769	94,110

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti fillestar për paga dhe mëditje për vitin 2017 ka qenë 7,012,775€, ndërsa në fund të vitit me vendim të Ministrit të Financave ky buxhet është zvogëluar edhe për 131,326€, pasi që procesi i rekrutimit të 30 inspektorëve ishte dërguar në gjykatë dhe nuk pritej krijimi i shpenzimeve në 2017. Realizimi i buxhetit ishte 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 443,839€, me vendim të Qeverisë. Përkundër rritjes realizimi i buxhetit ishte prej 94%;
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar është zvogëluar për 1,257,000€, me rishikim të buxhetit dhe me vendime të Qeverisë. Ky zvogëlim ndërlidhet me bartjen e projektit 'Sistemi i ri bazë të tatimeve' për vitin 2018, vlera e planifikuar për këtë projekt ishte 1,200,000, i cili ishte bashkëfinancim nga mbështetja e BE-së përmes fondeve të IPA² 2017 SBS. Edhe projekti 'Qendra e thirrjeve' në vlerë prej 50,000€ ishte bartur për vitin 2018, ndërsa projekti 'Softueri' është zvogëluar për 7,000€.

² IPA-Instrumenti i Para Anëtarësimit

Çështja 1 – Keq klasifikimi i buxhetit

E gjetura Sipas rregullës financiare nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare “Pasuri kapitale nënkupton të gjitha pasuritë jo financiare që kanë afat të përdorimit më të gjatë se një vit, vlerë financiare mbi 1,000€ për njësi, pronësia dhe kontrolli janë të organizatës”.

Pagesa në vlerë 50,998€ për vazhdim të mirëmbajtjes vjetore të licencave të Oracles, ishte kryer nga kategoria e investimeve kapitale, mirëpo rregullat e thesarit e kualifikojnë në kategorinë mallra dhe shërbime.

Rreziku Paraqitja jo e saktë e të dhënave në pasqyra financiare shpie në një keqkuptim të informatave financiare të ATK-së.

Rekomandimi 1 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se ka kontrolle të mira që sigurojnë planifikim/klasifikim adekuat të projekteve bazuar në planin kontabël të aprovuar nga Thesari-MF.

3.2 Të hyrat

Të hyrat tatimore të planifikuara nga Qeveria e Kosovës/MF për vitin 2017 ishin 423,000,000€, ndërsa të hyrat e realizuara nga ATK janë 414,355,302€, ka ngecje në realizimin e planit për 2%. Mirëpo krahasuar me vitin 2016, ATK në vitin 2017, ka realizuar të hyra bruto më shumë për 27,969,813€ apo 7%. Ndërsa të hyrat neto ishin në vlerë prej 365,916,273€.

Tabela 3. Të hyrat e inkasuara për buxhetin e Kosovës - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	Realizimi 2017	Realizimi 2016	Realizimi 2015
Të hyrat bruto	423,000,000	423,000,000	414,355,000 ³	386,385,187	332,772,000
Kthimet	(36,000,000)	(36,000,000)	(48,439,000)	(31,005,000)	(28,769,000)
Të Hyrat neto	387,000,000	387,000,000	365,916,000	355,380,187	304,003,000

ATK-ja në raportin e monitorimit të realizimit të planit vjetor kishte shpjeguar se rritja e të hyrave në vitin 2017 ishte edhe si rezultat i ndërmarrjes së veprimeve nga menaxhmenti i ATK-së, në forcimin e kontrolleve dhe veprimeve shtesë për arritjen e objektivave.

³ Vlerat e paraqitura në këtë tabelë janë të rrumbullakuara në zero-0,

3.2.1 Menaxhimi i të hyrave dhe kthimet

Të hyrat nga ATK-ja në vitin 2017 janë 414,355,302€. Burimet kryesore të të hyrave janë: tatimi në vlerën e shtuar (TVSH) me 47.5%, pastaj tatimi në të ardhurat personale (TAP) me 29.4% dhe tatimi në të ardhurat e Korporatave (TAK) me 23.2%.

Tabela 4. Të hyrat e inkasuar dhe kthimet sipas kodeve ekonomike (në €)

Përshkrimi	Kodet ekonomike	Viti 2017	Viti 2016
Tatimi i paragjykuar	40010	8	21,000
Tatimi në fitim	40020	-	1,000
Tatimi mbi vlerën e shtuar	40030	198,340,829	179,203,000
TVSH e shtyre	40035	0,00	90,000
Tatimi i pagave i mbajtur në burim	40040	85,635,355	79,850,000
Tatimi për biznese individuale	40050	32,547,167	32,125,000
Tatim.mbi qira.pasur.patrupëz.	40060	595,812	819,000
Tat.mbaj.bur.int.dre.pron.qir.	40065	18,145,526	11,187,000
Tatimi për korporata	40070	75,276,998	80,797,000
Konto kaluese - administrata tatimore	40090	(8,073)	7,000
Te hyrat gjobat	40095	3,426,234	2,187,000
Kompensimi i dëmeve nga kompanitë e sigurimeve	50109	30	1,000
Licencat për lojëra	50210	393,848	96,000
Të hyrat nga shitja e mbeturinave	50416	844	1,000
Te hyrat shitj.mallr.konfisk.	50421	723	0,00
Totali		414,355,302	386,385,000

Shuma e rimbursimeve/kthimeve tatimore për vitin 2017 ishte në vlerë prej 48,439,102€.

Table 5. Kthimet sipas kodeve ekonomike (€)

Përshkrimi	Kodet ekonomike	Viti 2017	Viti 2016
Kthimi i tatimit mbi vlerën e shtuar	40031	45,141,800	30,133,575
Kthim-tax ne paga - mbajt. Burim	40041	867,465	61,862
Kthim-tatimi për biznese	40051	94,932	185,042
Kthim-qira fitim loto drejt	40061	112,274	967
Kthim-tatimi për korporata	40071	2,219,630	621,445
Kthim-te hyrat-gjobat e ATK-se	40096	3,000	1,653
Totali - kthimet		48,439,102	31,004,544

Pjesëmarrje më të madhe në kthime ka TVSH-ja me 45,141,800€ ose 93% dhe tatimi në korporata me 2,219,630€ ose 5%, ndërsa kthimet nga tatimet tjera janë në vlerë më të vogël. Ne kemi testuar të hyrat dhe kthimet dhe kemi identifikuar çështjet si në vijim:

Çështja 2 - Mos harmonizimi i të hyrave sipas kërkesave ligjore

E gjetura

Sipas rregullores nr.03/2012, ATK është e obliguar që të bëjë barazimin e të hyrave me Thesarin në baza mujore dhe tremujore, dhe të jepen shënime sqaruese në lidhje me mosbarazimet ndërmjet Kontabilitet të ATK-së dhe shënimeve të Thesarit.

Zyrtarja e të hyrave kishte kryer barazime me Thesarin në baza mujore dhe tremujore. Mirëpo në raportet e barazimeve nuk janë dhënë shënime sqaruese për arsyet e mos barazimit SIMFK-Kontabilitet i ATK-së. Vlera e mosbarazimit për periudhën janar-dhjetor 2017 ishte prej 2,788,533€. Sipas ATK-së arsyet e mosbarazimit rrjedhin si rezultat i raportimit jo të saktë të pagesave nga Bankat Komerciale (pagesa pa UNIREF, raportimi i pagesave të tatimeve në llogari të pensioneve dhe anasjelltas etj.).

Rreziku

Mos dhënia e shënimeve sqaruese sa i përket ndryshimeve ndërmjet shënimeve Thesarit dhe kontabilitetit të ATK-së krijon paqartësi dhe informata të pa mjaftueshme për të hyrat dhe kthimet e ATK-së në përgjithësi.

Rekomandimi 2

Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se funksionojnë kontrollet dhe janë ndërmarrë veprime për të mundësuar që me rastin e harmonizimit të të hyrave dhe kthimeve të jepen shënime sqaruese për mosbarazimet ndërmjet shënimeve të Thesarit dhe Kontabilitetit të ATK-së, me qëllim që procesi i harmonizimit të jetë në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.

Çështja 3 – Mangësi në procesin e fiskalizimit

- E gjetura** Në planin e trajtimit të rreziqeve për vitin 2017 një ndër objektivat kryesore ATK kishte përcaktuar identifikimin dhe fiskalizimin e bizneseve, të cilat kërkohet të fiskalizohen e që ende nuk janë pajisur me arka fiskale.
- Sipas të dhënave të ATK-së numri i përgjithshëm i bizneseve që ushtrojnë aktivitete biznesore është gjithsej 65,745, prej tyre 46,558 janë deklarues në sistemin e tatimpaguesve të ATK-së në vitin 2017.
- ATK nuk ka të dhëna të sakta apo të përafërta se sa është numri i bizneseve që nuk janë të pajisura me arka fiskale, e që sipas legjislacionit kërkohet të jenë të fiskalizuara.
- ATK në vitin 2017 kishte shënuar progres në fiskalizimin e bizneseve që tregtojnë me karburante. Sipas shënimeve të ATK-së, numri i bizneseve në Kosovë që zhvillojnë tregti me derivate është 356, me gjithsej 605 pika të shitjes, prej tyre me arka fiskale janë të pajisura 584 pika të shitjes apo rreth 97%, ndërsa pa arka fiskale operojnë ende edhe 21 pika të shitjes.
- Rreziku** Mos identifikimi i saktë i bizneseve të cilat nuk janë të pajisura me arka fiskale si pasojë mund të kenë shmangien e mundshme tatimore, kjo rezulton me një konkurrencë jo të barabartë ndërmjet bizneseve që zhvillojnë aktivitete të caktuara.
- Rekomandimi 3** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë menaxhim të mirë, kontrolle të shtuara dhe veprime të nevojshme, me qëllim që bizneset të pajisen me arka fiskale konform kërkesave ligjore.

Çështja 4 - Vonesa në shqyrtimin e kthimeve (rimbursimeve)

E gjetura Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat, neni 30, obligon ATK-në që të aprovoj një kërkesë të vlefshme për kthim (rimbursim) brenda 60 ditëve nga data e pranimit të kërkesës në ATK. Nëse kërkesa nuk është shqyrtuar brenda këtij afatit, atëherë në këto raste ATK përveç kthimeve duhet të paguaj edhe interesin tatimpaguesve.

ATK këtë vit ka treguar progres në shkurtimin e afateve kohore në trajtimin e kërkesave për kthimet. Por përkundër kësaj ne identifikim se në pesë raste, kërkesat për kthim nuk ishin shqyrtuar brenda afatit ligjor, dhe ATK nuk i kishte paguar interesin tatimpaguesve për vonesat e ndodhura.

Rreziku Vonesat në rimbursime, mund t’iu shkaktoj bizneseve vështirësi financiare në ushtrimin e aktiviteteve të tyre operative si dhe rrezikohet dëmtimi i buxhetit të ATK-së si pasojë e hyrjes në obligime të interesit për biznese.

Rekomandimi 4 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë menaxhim adekuat dhe kontrolle në procesin e kthimeve/rimbursimeve, me qëllim që kërkesat të shqyrtohen brenda afatit të përcaktuara kohor dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike (MAP) dhe MF. Sipas shënimeve të SIMFK-së, buxheti për kategorinë e Pagave në ATK për vitin 2017 është 6,889,254€, i cili ishte shpenzuar 100%.

Çështja 5 - Pozita udhëheqëse me ushtrues detyre përtej afateve ligjore

E gjetura Neni 30 i Ligjit për Shërbimin Civil Nr.03/L-149 përcakton se “në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj”.

Në vitin 2017, 31 pozita udhëheqëse janë mbuluar me ushtrues detyre, dhe të gjitha kishin kaluar afatin ligjor. Në fillim të vitit 2018, 10 prej këtyre pozitave janë mbuluar me zyrtar të rregullt.

Rreziku Mbulimi i pozitave kyçe/menaxheriale me UD për një kohë më të gjatë se kërkesat ligjore, rrit rrezikun e mos arritjes së objektivave dhe përgjegjësia apo performanca e kërkuar në këto pozita të mos jetë në nivelin e duhur.

Rekomandimi 5 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet konformë kërkesave ligjore, që për pozitat e mbuluara me UD të bëhet një zgjidhje e qëndrueshme me pozita të rregullta në pajtim me kërkesat ligjore.

3.4 Menaxhimi i personelit

Ne testuam menaxhimin e proceseve në aspektin e pajtueshmërisë sa i përket menaxhimit të aktiviteteve në fushën e personelit, dhe identifikuam këto raste:

Çështja 6 - Mos funksionalizmi i plotë i strukturës së re organizative

E gjetura Edhe pse aprovimi i rregullores së re për sistematizimin e vendeve të punës në ATK ishte bërë më 30.06.2016 edhe më tutje në 2017 shtatë pozita nga departamente dhe divizione të ndryshme nuk janë funksionale⁴. Kjo ka rrjedhur si rezultat i mos marrjes së iniciativës nga ATK për shpalljen e konkurseve për mbulimin e këtyre pozitave.

Drejtori i Përgjithshëm (DP) i ATK-së gjatë vitit e ka ngritur çështjen e strukturës organizative tek MF. Sipas DP-së, MF ka sugjeruar që struktura organizative të jetë në përshtatje me legjislacionin e ri dhe planifikimeve (riorganizimeve) të reja që Ministria ka në plan të bëjë.

Rreziku Mos plotësimi apo vonesat në plotësimin e pozitave të caktuara me kandidatë përkatës, rrisin rrezikun që organizimi i planifikuar i ATK-së të mos jetë mjaftueshëm funksional dhe efektiv. Po ashtu rrezikon edhe arritjen e objektivave të përcaktuara.

Rekomandimi 6 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se ndërmerren veprime të vazhdueshme ligjore, që për pozitën e paplotësuar të bëhet një zgjidhje e qëndrueshme në pajtim me kërkesat ligjore.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2017 ishte 1,632,436€. Prej tyre janë shpenzuar 1,528,474€, apo 93% e buxhetit. Ndërsa buxheti për komunalitetin ishte 174,972€ nga i cili ishte shpenzuar 166,070€, apo 95% e buxhetit.

Në Memon e përkohshme të auditimit kemi vërejtur një rast, kur operatori ekonomik është shpërblyer me kontratë pa i përmbushur të gjitha kriteret⁵ e kërkuara të dosjes së tenderit për prokurimin "Shërbimet e përkthimit prej gjuhës shqipe, në gjuhën angleze dhe serbe dhe anasjelltas sipas kërkesave dhe nevojave të ATK-së". Pas kësaj, ATK më 29.12.2017 ka ndërmarre veprime duke ndërprerë kontratën me vullnetin e të dyja palëve dhe është zotuar se do të ndërmarr veprime për parandalimin e rasteve të tilla.

⁴ Në fillim të vitit 2018 ATK i ka mbuluar katër nga këto pozita me zyrtar të rregullt.

⁵ Kopjet e diplomave për një bashkëpunëtor të gjuhës angleze dhe dy të gjuhës serbe

3.6 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale në vitin 2017 ishte 263,000€. Prej tyre janë shpenzuar 231,453€ apo 88%. Me këto mjete janë realizuar pesë projekte që kanë të bëjnë me furnizimin me pajisje të IT-së dhe Softuerë për sistemet e ATK-së.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.7 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale. Ne testuam procesin e pagesave në të dy kategoritë ku identifikuam parregullsitë si në vijim:

Çështja 7 - Zotimi i mjeteve pas pranimit të mallrave dhe shërbimeve

E gjetura Sipas rregullës financiare 01/2013 për shpenzimin e fondeve publike, fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, procedohet urdhër-bleerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa.

Ne identifikuam se në katër pagesa⁶ zotimi i mjeteve ishte bërë pas pranimit të mallrave dhe shërbimeve, për këto pagesa zotimet ishin vonuar nga tri deri në 45 ditë.

Kjo ishte në mungesë të buxhetit dhe alokimit të mjeteve me vonesë, që ka rezultuar me vonesa në zotime të mjeteve.

Rreziku Hyrja në obligime pa zotim të mjeteve mund të rezultojë në mos kryerjen e obligimeve brenda afateve kohore dhe vonesa në implementimin e kontratave.

Rekomandimi 7 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime që kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave janë duke u monitoruar në vazhdimësi, për të mundësuar që procesi i furnizimit me mallra dhe shërbime, si dhe realizimi i pagesave të jetë në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.

⁶ Pagesat në vlerë prej 21,150€ dhe 24,715€ "Furnizim për zyre" dhe pagesat në vlerë 37,250€ dhe 22,350€ për projektin "Souftwer arka fiskale".

3.8 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Udhëzuesi kryesor në këtë fushë është rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore. Vlera e pasurive jo financiare kapitale me vlerë mbi 1,000€ e paraqitur në PFV ishte 1,692,000€, vlera e pasurisë jo financiare nën 1,000€ ishte 46,000€, si dhe vlera e stokeve ishte 88,000€.

Çështja 8 – Mos përdorimi i sistemit e-pasuria

- E gjetura** Përkundër rekomandimit të dhënë në raportin e viteve paraprake, për të përmirësuar menaxhimin e pasurive nën 1,000€ dhe stokeve, duke i evidentuar në softuerin e-pasuria, edhe me tutje gjendja ishte e njëjtë. Pasuritë jo kapitale dhe stoqet janë evidentuar dhe raportuar përmes një sistemi të brendshëm të tyre, derisa janë në proces të funksionalizimit të sistemit e-pasuria.
- Rreziku** Mos menaxhimi i pasurive jo kapitale nën 1000€ përmes sistemit e-pasuria si dhe regjistrimi i pasurive në data baza të ndryshme vështirësojnë menaxhimin efektiv të tyre.
- Rekomandimi 8** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që janë ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme dhe të monitoroj nga afër funksionalizimin e sistemit e-pasuria, në mënyrë që të sigurohet se pasurit jo kapitale dhe stoqet regjistrohen dhe menaxhohen përmes këtij sistemi.

3.9 Llogaritë e arkëtueshme

Llogarit e arkëtueshme në fund të vitit 2017 ishin 322,588,297€⁷, në këtë vlerë janë të përfshira edhe kontributet pensionale prej 23,989,691€. Ndërsa llogaritë e arkëtueshme të ATK-së pa kontribute pensionale në vitin 2017 janë 298,598,606€, dhe se krahasuar me vitin 2016 (284,366,199€) kemi rritje të LLA prej 14,232,407€ apo 5%.

Në bazë të Ligjit nr. 05/L-043 dhe Ligjit 05/L-119 për faljen e borxheve, shuma e borxheve të falura janar-gusht 2017⁸ ishte në vlerë prej 22,302,219€, ndërsa të hyrat e realizuara si efekt i Ligjit për falje të borxheve ishin 9,204,679€.

ATK ka të vendosur një sistem të kontrollit të brendshëm që mbikëqyrë procesin e llogarive të arkëtueshme, mirëpo trajtimi i të arkëtueshmeve vazhdon të mbetet sfidë për ATK.

⁷ Të arkëtueshmet për pensione, janë të arkëtueshme të Trustit Pensional të Kosovës, mirëpo pasi që ato menaxhohen nga ATK-ja, janë raportuar edhe në PFV-të e ATK-së.

⁸ Më 30 gusht të vitit 2017 ka skaduar ligji për faljen e borxheve

Çështja 9 - Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme

E gjetura Sipas planit të trajtimit të rreziqeve dhe planit të punës së ATK-së, për vitin 2017 ishte përcaktuar të inkasohen borxhet në vlerë 91,400,000€. Ndërsa janë inkasuar rreth 66,800,000€ apo 73% e planit.

Përqindja e borxheve (tatimi bazë) ndaj ATK-së është planifikuar të bie në nivel 10% të të hyrave të vitit paraprak, standard ky i rekomanduar edhe nga FMN⁹. Ndërsa shumica e borxhit (të hyrave të pa mbledhura) ndaj ATK-së në fund të vitit 2017 ishte në vlerë 121,977,774€ apo 32% e të hyrave të vitit paraprak.

Derisa në mungesë të veprimeve me kohë/adekuate në fund të vitit 2017 borxhi i vjetër arrin shumën prej 60,604,906€¹⁰.

Rreziku Mungesa e veprimeve të mjaftueshme për inkasim të të arkëtueshmeve publike mund të mos i inkurajon subjektet tjera që t'i paguajnë obligimet e tyre me kohë. Vjetërsia e të arkëtueshmeve e vështirëson mbledhjen e tyre.

Rekomandimi 9 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime në rritjen e efikasitetit si dhe forcimin e kontroleve në menaxhimin dhe arkëtimin e borxheve dhe njëkohësisht të jenë në linjë me rekomandimet e dala nga Raporti i fundit i FMN-së dhe standardet e agjencive të suksesshme tatimore.

3.10 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara në fund të vitit 2017 ishte 30,065€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Testet tona në këtë kategori shpalosën dobësi në menaxhimin dhe raportimin e obligimeve dhe tek detyrimet kontingjente.

Çështja 10 - Vonesa në ekzekutimin e pagesave si dhe mos raportim jo i rregulltë i obligimeve

E gjetura Rregulla financiare nr.01/2013/MF neni 37 pika 1 e – përcakton se “të gjitha faturat që i pranon organizata buxhetore duhet të paguhen brenda 30 ditëve në qoftë se nuk është paraparë ndryshe me kontratë”.

ATK nuk kishte raportuar rregullisht në MF lidhur me obligimet e pa paguara, përkatësisht nuk kishte hartuar raporte mujore për muajt janar, shkurt, mars, prill, maj, shtator dhe dhjetor të vitit 2017.

⁹ Ky standard i FMN (Fondi Monetar Nderkombetar) sqaron se Agjencitë e suksesshme tatimore zakonisht mbajnë borxhet e tyre tatimore në një nivel që është 10% të totalit të hyrave të vitit paraprak.

¹⁰ Borxhet e vjetra të pa mbledhshme- një borxh konsiderohet i pa mbledhshëm kur i ka kaluar afati i deklarimit apo vlerësimit të fundit mbi 6 vite. Gjithashtu me ligjin e ATK-së janë edhe disa specifika të përcaktuara për borxhet e pa mbledhshme edhe kur kalohet periudha 6 vjeçare e borxhit, si: rastet në gjykata, ankesat e bizneseve pran Bordit të pavarur për Rishqyrtime. Ndërsa për Organizatat Buxhetore, Ndërmarrje Shoqërore, Ndërmarrje Publike, Ndërmarrjet nën Menaxhimin e AKP-së, Kontributet Pensionale, Kooperativat Bujqësore, nuk ka vjetërsim të borxheve.

Po ashtu ATK është vonuar në shlyerjen e obligimeve të saj. Në pesë pagesa¹¹ të testuara janë vërejtur vonesa në pagesën e faturave nga 22 ditë deri në 133 ditë.

Rreziku Mos raportimi i rregullt i obligimeve ndikon që menaxhmenti të mos ketë një pasqyrë të qartë të obligimeve, e kjo rritë rrezikun që faturat të mos paguhen me kohë. Ndërsa vonesat në shlyerjen e obligimeve mund të bartin kosto shtesë.

Rekomandimi 10 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë menaxhim dhe kontrole adekuate që raportimi i obligimeve të jetë i rregullt dhe se këto raporte japin informata të sakta dhe të plota për menaxhmentin dhe Thesarin. Po ashtu në raportimet mujore duhet të përcjellët kronologjia e faturave të papaguara me qëllim të pagesës me kohë të tyre.

Çështja 11 - Detyrimet kontingjente

E gjetura Detyrimet Kontingjente në PFV e ATK-së për vitin 2017 janë prezantuar në vlerë 76,352€, ndërsa në vitin 2016 ishin 61,000€. Përderisa, në të dhënat e Avokaturës Shtetërore (ASh) janë prezantuar 116 raste apo aktvendime ku janë ngritur padi ndaj ATK-së. Këto raste nga listat e ASh nuk janë prezantuar në PFV. Si rrjedhojë vërehet mungesë e koordinimit të duhur ndërmjet ATK-së dhe ASh rreth lëndëve/informatave rreth detyrimeve kontingjente.

Rreziku Mungesa e një qasje adekuate për trajtimin e detyrimeve kontingjente rrit mundësinë e shndërrimit të tyre në obligime që do të shkaktonte keqësimin e pozitës financiare të organizatës.

Rekomandimi 11 Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj kontrole adekuate në këtë fushë, të siguroj raportim cilësorë dhe bashkëpunim/koordinim me Avokaturën Shtetërore me qëllim të përfaqësimit adekuat të institucionit në gjykata.

¹¹ Pagesat (2) për qira në vlerë nga 7,122€, pagesa për karburant për vetura vlera 12,123€, shpenzimet postare vlera 870€ dhe shpenzimet e telefonit në vlerë 5,391€.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2016, ka rezultuar me 13 rekomandime. ATK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, pesë rekomandime janë zbatuar, katër ishin në proces dhe katër nuk janë zbatuar ende. Rekomandimet e pa zbatuara janë mbulimi i pozitave me ushtrues detyre, keq klasifikimi i projekteve në buxhet dhe menaxhimi i pasurive jo kapitale nën 1,000€ jo përmes sistemit e-pasuria. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur edhe dy rekomandime të cilat nuk janë adresuar të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e pasurive nën 1,000€ dhe llogaritë e arkëtueshme. Përshkrimi më i plotë rreth rekomandimeve dhe trajtimit të tyre - Shtojca II.

Çështja 12 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

- E gjetura** Përkundër hartimit të planeve për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm (AP), edhe me tutje ka rekomandime të pa zbatuara nga viti i kaluar dhe atyre të mëhershme. Si rrjedhojë parregullsitë dhe dobësitë e njëjta janë shfaqur edhe këtë vit.
- Rreziku** Zbatimi jo i plotë i rekomandimeve ndikon në mos përmirësimin e dobësive të identifikuar, si rezultat rreziqet dhe efektet mund të jenë më të mëdha dhe të mos kontrollohen.
- Rekomandimi 12** Drejtori i Përgjithshëm duhet të zbatojë një proces efektiv për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të AP-së, i cili përcakton kohën e synuar dhe zyrarët përgjegjës për këtë. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

ATK në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet ligjore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Qeverisja në ATK në fushën e raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, si dhe menaxhimin e rrezikut pasqyron një situatë pozitive. ATK ka përgatitë planin për zbatimin e rekomandimeve, ka përbushë kërkesën lidhur me dorëzimin e pyetësorit të vetëvlerësimit. Lista e vet-vlerësimit e plotësuar nga MF kishte paraqitur gjendje të saktë të organizatës dhe ishte përcjelle me dëshmitë përkatëse. ATK kishte hartuar strategjinë gjithëpërfshirëse të zhvillimit të institucionit për vitet 2015-2020, planin për menaxhimin e rreziqeve si dhe planin për monitorimin e rreziqeve.

Megjithatë ATK në raportet e monitorimit të planit për menaxhimin e rreziqeve nuk ka dhënë informata në lidhje me arsyet e mos përbushjes së planit të kontrolleve tatimore dhe progresi në zbatimin e rekomandimeve nuk është i mjaftueshëm.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

NJAB në skemën organizative është njëri nga segmentet kyçe të kontrolleve të brendshme.

Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i raporteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me katër anëtarë - Drejtori i NJAB-së dhe tre auditor. NJAB kishte hartuar planin strategjik dhe vjetor ku janë planifikuar tetë auditime të rregullta dhe dy sipas kërkesës së menaxhmentit, gjatë vitit 2017 NJAB kishte kryer shtatë auditime të rregullta, si dhe dy sipas kërkesës, ndërsa një nga raportet e planifikuara që të kryhet në vitin 2017 për procedurat e prokurimit është kryer në muajin shkurt të vitit 2018.

Drejtoritë/departamentet që auditohen nga NJAB obligohen të raportojnë në periodha tremujore lidhur me nivelin e implementimit të rekomandimeve.

NJAB raporton për punën e saj edhe në NJQHAB përmes raporteve tremujore dhe linja tjetër e raportimit është Komiteti i Auditimit i cili është themeluar në kuadër të Ministrisë së Financave.

Komiteti i Auditimit, për periudhën janar-dhjetor 2017 ka mbajtur katër takime ku janë shqyrtuar raportet e AB-së, të gjeturat dhe implementimi i rekomandimeve të tyre.

Çështja 13 – Fushëveprimi i auditimit kryesisht mbulon vitin paraprak

E gjetura Raportet e auditimit të brendshëm në masë më të madhe (rreth 57%) kanë trajtuar aktivitetet dhe sistemet operative që mbulojnë vitin paraprak.

Rreziku Orientimi i fushëveprimit i NJAB-së në masë të konsiderueshme në vitin e kaluar, zvogëlon sigurinë apo mundësinë për ndërmarrjen e veprimeve parandaluese që mund t'i ofrohen menaxhmentit informatat në lidhje me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Rekomandimi 13 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se plani i NJAB mbështetet në masë të konsiderueshme në fushëveprimin e vitit aktual, një qasje pro aktive do të mundësonte që parregullsitë apo devijimet e mundshme në sistemet e kontrollit të adresohen në kohën e duhur.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për një planifikim të mirë, për mbikëqyrje të aktiviteteve në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

ATK është agjenci në kuadër të MF-it, ka strukturën e saj organizative, menaxhuese dhe llogaridhënëse dhe se Drejtori i Përgjithshëm raporton te Ministri i Financave në periudha të rregullta mujore. Departamentet në kuadër të ATK-së kanë plane veprimi për zbatimin e objektivave të parapara me aktivitetet e tyre operative, dhe njëherit në baza mujore dhe tremujore kryejnë monitorimin apo matjen e arritjes së objektivave të përcaktuara me plan strategjik, dhe planin operativ të punës për vitin 2017.

Ndonëse menaxhmenti ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme, edhe më tutje duhet t'i kushtojë rëndësi më të madhe proceseve në menaxhimin e të hyrave, fushën e personelit dhe në menaxhimin e pasurive dhe llogarive të arkëtueshme.

5.2.1 Kontrolla tatimore

Si rezultat i kryerjes së kontrolleve tatimore, janë realizuar të hyra në vlerë prej 53,000,000€ të cilat janë përfshirë në të hyrat e përgjithshme të ATK-së. Realizimi i tatimit shtesë është më i lartë për 3,900,000€ apo 7.5 % në raport me vitin e kaluar.

Numri më i madh i kontrolleve të kryera është në kuadër të bizneseve të mesme gjithsej 498 kontrolle apo 34.5%, pastaj të bizneseve të mëdha me 380 kontrolle apo 26%, bizneset mikro me 285 kontrolle apo 20%, dhe bizneset të vogla me 191 kontrolle apo 13% si dhe "Drejtoria e tatim paguesve të mëdhenj (DTM) me 90 kontrolle apo 6%. Dobësitë e vërejtura janë si në vijim:

Çështja 14 - Mos realizimi i planit të kontrolleve

E gjetura Sipas planit të punës për vitin 2017 ishte paraparë realizimi i 1,976 kontrolleve, ndërsa janë realizuar gjithsej 1,444 kontrolle apo 73% e planit. Ngecje në realizimin e planit kanë shënuar Regjionet si Mitrovica, Prishtina 1, Prishtina 2, Peja dhe Gjlani. Arsyet kryesore të paraqitura nga zyrtarët e ATK-së që kanë ndikuar në mos realizimin e planit janë: kërkesat nga Institucionet e tjera si Policia, Njësia e Inteligjencës në MF, Prokuroria, Inspektorati i Minierave dhe Mineraleve, Inspektoratet komunale për të kryer aktivitete të përbashkëta.

E gjetura Hapja e rasteve të kontrollit duhet të bëhet në ato lloje të tatimeve dhe periudhave tatimore për të cilat vlerësohet se kanë shkallë të lartë të rrezikshmërisë duke respektuar Analizën e rrezikut. Sipas planit 2/3 e kontrolleve për vitin 2017 do hapen nga zyra qendrore, ndërsa 1/3 e kontrolleve të hapura do jenë nga vlerësimi i zyrave regjionale.

Mirëpo nga gjithsej 1,444 kontrolle të kryera, 315 raste të kontrolleve janë kryer të propozuara nga zyra qendrore analiza e riskut. Sipas planit do të duhej të kryhen rreth 960 kontrolle të propozuara nga zyra qendrore. Kontrollat e kryera me propozim të zyrës qendrore kanë rezultuar më të efektshme në të hyrat shtesë.

Rreziku Mos realizimi i kontrolleve sipas planit dhe kriterëve të përcaktuara mund të rezultojë në mos hapjen e rasteve për kontroll të bizneseve të identifikuara me rrezikshmëri të lartë, si dhe mos përmbushjen e detyrimeve tatimore apo shmangie në të hyra për BRK-në.

Rekomandimi 14 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime konkrete që mundësojnë realizimin e planit të kontrolleve dhe se rastet për kontroll të merren në bazë të analizave/prioriteteve të planifikuara në mënyrë që të shmangët mos përmbushja e detyrimeve tatimore nga subjektet/tatimpaguesit.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimi të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë vitit 2017	Të pa zbatuara
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak.	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e rekomandimeve të bëra nga AP për vitin e kaluar.		Në proces të zbatimit gjatë 2017.	
3.4 Të hyrat.	Drejtori i Përgjithshëm duhet të shtoj masat për identifikimin e shkaktarëve për të dhënat jo konsistente dhe eliminimin e tyre në mënyrë që të sigurohet harmonizimi i të dhënave lidhur me rimbursimet.		Në proces të zbatimit gjatë 2017, ne raporte me vitet e kaluara nr. i ditëve mesterë për rimbursim e është shkurtuar dhe nr. i rasteve të paraqitura si vonës është zvogëluar dukshëm.	
3.4 Të hyrat.	Drejtori i Përgjithshëm duhet të shtoj kontrollet për të siguruar që kërkesa e tatimpaguesve të aprovuara për rimbursim të shqyrtohen brenda afatit të përcaktuar kohor.		Në proces të zbatimit, pasi janë zvogëluar ditët për trajtimin e kërkesave për kthime.	
3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale.	Drejtori i Përgjithshëm duhet të rishikoj kontrollet ekzistuese në menaxhimin e pasurisë. Kontrollet në këtë fushë duhet të forcohen në mënyrë që pasuritë të ruhen nga humbja keqpërdorimi.			Nuk është zbatuar.
3.7.3 Trajtimi i të arkëtueshmeve.	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj ndërmarrjen e masave të duhura, përfshirë veprimet ligjore në mënyrë që të shtoj efikasitetin në inkasimin e parasë publike.			Nuk është zbatuar

Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak.	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që plani i veprimit, rishikohet, duke analizuar shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara, dhe të përcaktojë një afat të ri kohor, si dhe stafin llogaridhënës për zbatimin e tyre. Në fokus fillestar duhet të jenë fushat e një rëndësie më të madhe. Zbatimi i këtij plani duhet të monitorohet në vazhdimësi.		Në proces të zbatimit gjatë 2017, ATK kishte pagatitë brenda afati ligjore planin për implantimin e rekomandimeve të dalura nga Raporti i Auditimit nga ZKA për vitin 2016, në funde vite kishte përgatitë edhe raportin e monitorimit të rekomandimeve ku kishte paraqitë të dhëna në lidhje me veprimet e ndërmarr, mirëpo edhe me tutje disa nga rekomandimet nuk janë adresua.	
2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike	Drejtori i Përgjithshëm duhet sigurojë se janë ndërmarr veprime të nevojshme për të eliminuar barrierat me MAP-in si dhe të fillohet me procedura të rekrutimit që mundësojnë plotësimin e pozitave me zyrtar të rregulltë brenda një afati të arsyeshëm kohor, në mënyrë që të arrihet funksionalizimi i plotë i strukture organizative në ATK.			Nuk është zbatuar.
3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit.	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë forcuar linjat raportuese, në mënyrë që planifikimi dhe buxhetimi i projekteve të caktuara bëhet bazuar në planin kontabël të aprovuar nga Thesari.		Në proces të zbatimit edhe me tutje një projekt ishte orientuar gabimisht në kategorinë ekonomike investime kapitalë është dashtë të orientohet në kategorinë mallra dhe shërbime, furnizim me licenca jeta e përdorimit një vjeçare.	

3.1.1 Të hyrat.	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se procesi i harmonizimit të të hyrave zhvillohet në pajtueshëri me kërkesat ligjore, si dhe të siguroj se ofrohen shënimeve të kontabilitetit të ATK-së me raportet e Thesarit. Kjo duhet të bëhet me qëllim që t'i mundësoj menaxhmentit të ATK-së të merr vendime bazuar në informatat e sakta dhe të plota.		Ne proces të zbatimit Procesi i harmonizimeve me Thesarin ishte bere ne baza mujore dhe trenujore, mirëpo ne krahasimin ete dhënave ndërmjeti shënimeve te Thesarit dhe ATK-se nuk janë dhëne sqarime shtese ne lidhje me mos barazimin e te dhënave ne fushën e te hyrave dhe kthimeve.	
3.1.1 Të hyrat.	Drejtori i Përgjithshëm në koordinim me Departamentin e Thesarit duhet të sigurojnë kontrolle shtesë për të siguruar harmonizim të plotë të të dhënave lidhur me kthimet.	Është zbatuar.		
3.1.1 Të hyrat/kthimet.	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarr veprime shtesë që kërkesat për kthime (rimbursime) të shqyrtohen brenda afatit të përcaktuar kohor dhe në pajtueshëri me kërkesat ligjore.		Në proces të zbatimit gjatë 2017, ne raporte me vitet e kaluare nr. i ditëve mestarë për rimbursim e është shkurtuare dhe nr. i rasteve te paraqitura si vonës është zvogëluar dukshëm.	
3.1.1 Të hyrat/procesi i fiskalizimit.	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë shtuar kontrollet si dhe janë ndërmarrë masat e nevojshme, për të obliguar të gjitha bizneset që merren me tregtimin e derivateve pajisen me arka fiskale.	Është zbatuar.		
3.1.1 Të hyrat.	Drejtori i Përgjithshëm duhet ndërmarrë të gjitha veprimet për siguruar së bizneset e çregjistruara nuk zhvillojnë aktivitete afariste dhe nuk realizojnë të hyra në emër të biznesit të çregjistruar	Është zbatuar.		

3.1.2 Paga dhe meditje	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore ku për pozitat e mbuluara me U.D bëhet një zgjidhje e qëndrueshme dhe në pajtim me kërkesat ligjore.			Nuk është zbatuar.
3.1.2 Paga dhe meditje	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë respektimin e afateve ligjore lidhur me angazhimin e stafit për kontrata-shërbime të veçanta.	Është zbatuar.		
3.1.3 Mallra dhe shërbime, shërbime komunale	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që respektohen kërkesat ligjore në lidhje me detyrimet që rrjedhin nga Aktgjykimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës.	Është zbatuar.		
3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale.	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që janë ndërmarr të gjitha masat e nevojshme që pasurit jo kapitale regjistrohen dhe menaxhohen përmes sistemit e-pasuria.			Nuk është zbatuar.
3.2.2 Llogaritë e arkëtueshme (borxhet).	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se ka forcuar kontrollin në menaxhimin e të arkëtueshmeve, rritjen e efikasitetit si dhe forcimin e kontrolleve në menaxhimin dhe arkëtimin e tyre. Në këtë aspekt, të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve në mënyrë që të ndërmerren veprimet ligjore për mbledhjen e tyre.			Nuk është zbatuar.

Shtojca III: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE / DATUM / DATE: 26.06.2018			
Nivësi Org. Org. Unit: 03	Shif. Klasif. Class Code: 47	Nr. Prot. Prot. No.: 1980	Nr.faqeve Br. Stranica / No. Pages: 1
Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo Qeveria - Vlada - Government Ministria e Financave - Ministarstvo za Financije - Ministry of Finance Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo			
Nivësi Org. Org. Unit:		Nr. Prot. Br. Prot.: 09-06-2568	Nr.faqeve Br. Stranica / No. Pages:
Arkiva / ARHIVA / ARCHIVE		Data Datum / Date: 26.06.18	Prishtinë / Pristina

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Administratës Tatimore të Kosovës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Sakip Imeri

Drejtor i Përgjithshëm - Administrata Tatimore e Kosovës,

Data: 25 Qershor 2018, Prishtinë,

